



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSh. nr. 105/2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenit 111 paragrafi 1 pika të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik OE "Europrint Group", për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me paisje për salla dhe terrene sportive" me nr. prokurimi 616/22/12784/111, iniciuar Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK), Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Vjosa Gradinaj Mexhuani me 03.05.2023, mori këtë:

**VENDIM**

1. Hedhet si e pa lejuar, ankesa OE "Europrint Group" e parashtruar me 20.02.2023 ,(Nr. të Protokollit 105/2023) lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me paisje për salla dhe terrene sportive" me nr. prokurimi 616/22/12784/111, iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

2. I lejohet autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me paisje për salla dhe terrene sportive" me Nr. prokurimi 616/22/12784/111, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër.

**Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

AK, me 11.11.2022 kishte publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit

“Furnizim me paisje për salla dhe terrene sportive” me nr. prokurimi 616/22/12784/111. Kurse me 03.02.2023, AK kishte publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës ndaj operatorit ekonomik NTG “Blendi”.

OE “Europrint Group” i pakënaqur me njoftimin e AK-së, me 20.02.2023 kishte parashtruar ankesë në OSHP (Nr. protokoll 105/23) për aktivitetin e cituar si më sipër.

Pas administrimit të ankesës në fjalë nga zyrtarja për të hyra dhe kthim të depozitës është vërejtur se OE nuk ka paguar tarifën për ankesën e parashtruar 105/23 dhe se mjetet për pagesën e tarifës nuk kanë dal në xhirollogarinë e OSHP-së.

Nisur nga fakti, se Ankuesi nuk kishte paguar tarifën, OSHP përmes emailit me 07 mars 2023, ia kishte kthyer te njëjtën Ankuesit për plotësim duke i sqaruar se ankesa duhet të ridërgohet e plotësuar se bashku me konfirmim të bankës për tarifën paguar.

Ankuesi deri me datën 27.04.2023, nuk ka bërë pagesën e tarifës sipas kërkesës së institucionit, duke ofruar dëshmi-konfirmim nga banka për pagesën e tarifës se ankesës në fjalë dhe njëkohësisht nuk i është përgjigjur email të OSHP-së.

Tutje me dt.02.05.2023 zyrtarja për pranim të ankesave informon po ashtu panelin, se ne E-prokurim tek E- ankesat figuronte qe ankesa ishte dorëzuar me dt.20.02.2023 ne ditën e 10-te kalendarike mirëpo pas verifikim tek pjesa e E-ankesave të dorëzuara në E-prokurim në të cilën shfaqen në mënyrë detale të dhënat lidhur me ankesat, ka vërejtur se kjo ankesë (Nr.protokoll 105/23 ) ishte deponuar me 20.02.2023 mirëpo e njëjta ishte dorëzuar nga ankuesi ne ora 17:03h që realisht i bie dita e 11-të dhe si e tillë kjo ankesë është po ashtu e jashtafatshme sipas Ligjit për Prokurimin Publik.

Andaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit, duke ju referuar sqarimeve të dhëna si me lart erdhi në përfundimin, se ankesa e OE “Europrint Group” me seli në Prishtinë e parashtruar me datën 20.02.2023, me nr protokoll 105/2023, për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me paisje për salla dhe terrene sportive” me nr. prokurimi 616/22/12784/111, iniciuar Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK), është e palejuar, konform Rregullores se OSHP-se nr.01/2020 (e amandamentuar).

Andaj mbi bazën e te lartëcekurave Kryetarja e OSHP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP  
Vjosa Gradinaj – Mexhuani

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Prishtinës

1x1 OE "Europrint Group"

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së



140123  
27.04.23



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Në mbështetje të nenit 98 dhe nenit 107 pika 1 të Ligjit Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën : 26.04.2023 mori këtë :

**V E N D I M**

**Mbi lejimin e udhëtimit zyrtar**

- Lejohet udhëtimi zyrtar i Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Kryetare e OSHP, Vedat Poterqoi-Anëtar i Bordit të OSHP, Kimete Gashi-Anëtare e Bordit të OSHP, dhe Agon Ramadani Anëtar i Bordit të OSHP, që të udhëtojnë zyrtarisht për në Ankara – Turqi, për pjesëmarrjen në Seminarin për Rrjetin e Organeve Shqyrtuese të Prokurimit Publik në Eventin e Evropës Juglindore në Ankara, për anëtarësimin e shtetit të Turqisë në rrjet, të organizuar nga “Autoriteti i prokurimit publik i Turqisë”.
- Ky udhëtim zyrtar do të realizohet në muajin Maj, nga data : 03.05.2023 e deri me datën: 06.05.2023.
- Për realizimin e këtij udhëtimi lejohen mjetet financiare, konform Rregullores – Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbulimin e shpenzimeve, ushqimit, akomodimit, fjetjes dhe transportit.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së dhe Zyrtari Kryesor Financiar i OSHP.
- Ky vendim hynë në fuqi nga dita e marrjes së të njëjtit.

**Vendimi i dërgohet:**

- Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së;
- Zyrtarit Kryesor Financiar të OSHP-së;
- Zyrës së Personelit të OSHP-së;
- Arhives së OSHP-së.

Prishtinë,  
26.04.2023

Kryetaria e OSHP  
Vjosa Gradinaj Mexhuani